



PËRDITËSIM

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të drejtuar pyetje.

Më 30 shtator, në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, Zyra e Prokurorit të Specializuar dorëzoi Aktakuzën e ndryshuar të konfirmuar, në pajtim me dy vendime të mëhershme në korrik dhe shtator të Gjykatës të Procedurës Paraprake.

Në vendimin e tij të 22 të shtatorit, Gjykatësi urdhëroi Prokurorin e Specializuar të shtonte emrat e kryesve të drejtpërdrejtë dhe të viktimave përkatëse si dhe vendndodhjet përkatëse në disa paragrafë të Aktakuzës. Po më 29 shtator, Gjykatësi miratoi kërkesën e Prokurorisë për heqjen e pretendimeve për krime të kryera kundër më së paku një viktime në një shtëpi në Ferizaj ose rreth tij.

Versioni i redaktuar publik i Aktakuzës së ndryshuar gjendet në faqen e internetit të DHSK-së.

Në të njëjtën çështje, të hënën Prokuroria njoftoi Gjykatësin e Procedurës Paraprake për përfundimin e disa hapave proceduralë sa i përket nxjerrjes së materialeve të rregullës 102(3) për Mbrojtjen. Ky ishte një nga hapat e kërkuar proceduralë për të cilin Gjykatësi i Procedurës Paraprake kishte caktuar afate përpara kalimit të çështjes për gjykim.

Për sqarim: rregullat përcaktojnë që Prokuroria duhet t'i japë Mbrojtjes të gjitha materialet që mbështesin Aktakuzën, deklaratat e dëshmitarëve dhe provat materiale që Prokuroria synon të përdorë në gjykim, si dhe provat që mund të jenë shfajësuese.

Krahas këtyre materialeve, Prokuroria, sipas rregullës 102(3), duhet të njoftojë Mbrojtjen lidhur me të gjitha materialet që zotëron. Kjo i jep mundësi Mbrojtjes të kërkojë cilindo prej këtyre materialeve që i konsideron të rëndësishme për përgatitjen e mbrojtjes.

Më 3 tetor, Prokuroria konfirmoi se ka përfunduar përpunimin e kërkesave të Mbrojtjes lidhur me nxjerrjen e materialeve të rregullës 102(3), ka kërkuar masa mbrojtëse, aty ku ishte e përshtatshme, dhe ka nxjerrë të gjitha materialet e kësaj rregulle që nuk janë objekt i masave mbrojtëse.

Po më 3 tetor, Zyra Administrative i dorëzoi Gjykatës të Procedurës Paraprake Raportin e Shtatë mbi Kërkesat e Viktimave për Pjesëmarrje në Proces, në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*. Deri tani, janë pranuar të marrin pjesë në proces 32 viktime në këtë çështje dhe procesi vazhdon të jetë i hapur.





Në çështjen *Pjetër Shala*, Trupi Gjykes ka caktuar datat 18-20 tetor për konferencat përgatitore për gjykim, ndërsa 21 tetorin si datë rezervë. Trupi Gjykes ka kërkuar parashtrime me shkrim nga Prokuroria, Mbrojtja, mbrojtësi i viktimave dhe Zyra Administrative lidhur me aspekte si hetimet, nxjerrja e materialeve dhe zhvillimi i procesit gjyqësor.

Seancat publike transmetohen me 45 minuta vonesë në faqen e internetit të DHSK-së, në shqipe, serbishte dhe anglishte. Personat e interesuar në Hagë mund t'i ndjekin seancat nga galeria për publikun e Gjykatës.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

